



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

**P.nr.693/16**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtorit profesional Visar Zeqiri, në lëndën penale ndaj të pandehurit A. B. nga fsh. D. e M. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.1613/2015, të dt.19.10.2016, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhru me kërkesen e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me dt.10.03.2017, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.1613/2015, të dt.19.10.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Ndaj të pandehurit:

**A. B.**, nga i ati K., i lindur më datën *data e lindjes...*, nga fsh. D. e M. K. L., ku edhe jeton, me numër personal *numër personal...*, shqiptar, shtetasë i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

Me datë 20.02.2015, rreth orës 13:50, në fshatin Ribar i Madh K. Lipjan, i pandehuri derisa ka qenë duke e drejtuar automjetin e tipit “Audi B 4”, me ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi rregullat e trafikut publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 42 të LSRRK-së, duke mos i dhënë përparësi kalimi pjesëmarrësve tjerë në pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, dhe deri sa ishte duke lëvizur në kthesë kalon në shiritin e kundërt qarkullues dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën e përparme anës së majtë automjetin e tipit “VW Pollo”, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, me ngjyrë të kuqe, të cilin e drejtonte tani i dëmtuari S. Sh., me ç’rsat pëson lëndime të lehta trupore,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve, 1, 2, 3, 4, 7, 17, 41,42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe neneve 493 dhe 495 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e,

**G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumë prej 250 €, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

**I dëmtuari:** S. Sh. nga fsh R. i M., udhëzohen që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajë, shumën prej 60.88-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 30-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr.1613/2015, të dt.19.10.2016, e ka akuzuar të pandehurin A. B. nga fsh. D. e M. K. L., për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurës ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht, Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. G., të dt.11.04.2016, dhe Mendimi dhe konstatimi i ekspertit së komunikacionit B.S., të dt.28.05.2015, dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale të cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrorit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për detyrimin e të akuzuarit që t'ia kompensojë dëmin respektivisht kërkesën pasurore - juridike, të dëmtuarit u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.693/16, me dt.10.03.2017**

**Bashkëpunëtori Profesional**

Visar Zeqiri

**GJYQTARI**

Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.